



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4264 prot.

Himarë, më 12.06 . 2026

VENDIM

Nr. 24 , datë 04.06 . 2026

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR
DËMTIMIN E BANESËS SË Z. JORGO NERANXI NË HIMARË, NGA FATKEQËSITË
NATYRORE”**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54; Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”; VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin dhe organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”; VKM nr. 835, datë 03.12.2004 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”; si dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

Në përgjigje të kërkesës me nr. 980 prot., datë 06.02.2026, të paraqitur nga z. Jorgo Neranxi, banues në Himarë; në zbatim të Urdhrit nr. 27, datë 14.01.2026, “Për ngritjen e komisionit për konstatimin dhe evidentimin e dëmeve në banesa nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera”; bazuar në informacionin dhe procesverbalin “Për dëmet në banesën e z. Jorgo Neranxi”, dërguar Kryetarit të Bashkisë me nr. 980/1 prot., datë 03.03.2026; shkresën nr. 980/2 prot., datë 18.03.2026, drejtuar Këshillit të Qarkut Vlorë, me objekt “Procesverbal i mbi dëmet e shkaktuara nga reshjet”; si dhe shkresën “Dërgim dokumentacioni për banesën e përmblytur të z. Jorgo Neranxi”, me nr. 980/3 prot., datë 30.03.2026, të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore pranë Këshillit të Qarkut Vlorë;

Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e tij të datës 04.06.2026 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga drejtoria e mbrojtjes së territorit dhe emergjencave civile, për miratimin e dhënies së dëmshpërblimit financiar për dëmtimin e banesës së z. Jorgo Neranxi në Himarë, nga fatkeqësitë natyrore, vendosi me 18 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim,

1. Të miratojë dhënien e dëmshpërblimit financiar për dëmtimin e banesës së z. Jorgo Neranxi në Himarë, nga fatkeqësitë natyrore.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55, pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

